



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:024230
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06034318

P.nr. 57/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në lëndën penale kundër të pandehurit Rr.Q...nga fshati D..., komuna e V..., për shkak të veprës penale Tregti i palejuar nga neni 299 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-s), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.200/2021, të datës 08.02.2021 dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP.II.nr.200/2021, të datës 07.06.2024, më datën 09.08.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit: Rr.. (J..) Q. nga fshati D., komuna e V., i lindur më .., me numër personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse me dt. 28.01.2021, rreth orës 13:00 min, në fshatin Sodovinë e Muhaxherëve, Komuna e Vitisë, derisa i pandehuri kishte qenë duke e drejtuar automjetin kombi të markës “VË”, ngjyrë e kaltër, me tabela të regjistrimit ..., ndalet nga Njësia e Taskë Forcës e Policisë Kufitare – Lindja Kaçanik kontrollë, me ç’rast gjatë kontrollës kanë vërejtur se i pandehuri në automjetin e tij kishte të ngarkuar një kafshë (lopë), me numra të matrikullit në njërin vesh, KS 11604511, për të cilën kafshë i pandehuri nuk ka poseduar dokument lidhur me prejardhjen e saj, ndërsa sipas inspektorit të AUV-it është konstatuar se që te kafsha nuk përputhet moshja dhe raca me të dhënat në data bazë e AUV-it me gjendjen faktike.

- me çka ka kryer veprën penale, Tregtia e palejuar nga neni 299 paragrafi 2 të KPRK-s.
Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69,70,71, dhe 72 të KPRK, dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

I. Të pandehurit Rr.Q...i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilin është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarin do ti zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. Konform nenit 299 paragrafi 4 të KPRK-s, KONFISKOHET kafsha-Lopa e sekuestruar.

IV. E dëmtuara, Administrata Tatimore e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontëst të rregullt civil.

V. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20 €, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit Rr.Q...nga fshati D., komuna e V., për shkak të veprës penale tregti i palejuar nga neni 299 paragrafi 2 të KPRK-s. Gjithashtu Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit Rr.Q...nga fshati D., komuna e V.. dhe të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet: raporti i shpejtë me nr. 2021-YEB-004 të dt.01.02.2021, kërkesa për sekuestrim të përkohshëm të mallit (kafshës), vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 29.01.2021, formulari mbi pranimit dorëzimit të mjetit të SPMK-Zhegër të datës 28.01.2021, procesverbali i AUV- it 001840 i dt. 28.01.2021, deklarata e të pandehurit Rr.Q...e dhënë në Polici me dt. 28.01.2021, raporti i oficerit, foto dokumentacioni dhe raporti i doganës lidhur me vlerësimin e kafshës- mallit si dhe shkesa të tjera të lëndës, vërtetojnë se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale ndotja, degradimi apo shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të KPP, kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 462 paragrafi 2 të KPP. Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI

**Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.57/2021, Më 09.08.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale,
Kadisha Ajvazi Demi**

**Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.